



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 09-052-01-11361-26

Nr. i fq. / Br.str. / No.pg. 1-2

Data / Datum / Date 24.04.2026

OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
**KOMUNA E OBILIQIT**  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



## DREJTORIA PËR MBROJTJE TE MJEDISIT

Duke u bazuar në nenin 68 të ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe paragrafin 4 të nenit 17 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, paraqet këtë:

### RAPORT

Draft

**RREGULLORE NR. \_\_/26 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 03/2024 TË PLOTËSUAR DHE NDRYSHUAR RREGULLOREN NR. 02/2023 PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E OBILIQIT**

Bazuar në vendimin me nr.02-020-01-9925-26 datë 10.04.2026 për formimin e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 03/2024 të plotësuar dhe ndryshuar rregulloren nr. 02/2023 për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Obiliqit,

Pas pranimit të vendimit të lartëcekur dhe pranimit të kërkesës nga DSHPE dhe DMM për rekomandimin dhe plotësimin e neneve të caktuar, komisioni ka filluar punën për të plotësuar dhe ndryshuar rregulloren, andaj me datë 14.04.2026 është mbajtur takimi i parë ku janë prezantuar materialet dhe ka filluar punë në ndryshim dhe plotësim, po ashtu komisioni ka mbajtur edhe dy mbledhje tjera para konsultimit publik takimet e mbajtura me datë 16.04.2026 ora 13:30 dhe 21.04.2026-ora10:00,

me datë 23.04.2026 ora 13: 30 është mbajtur konsultimi publik në sallën e kuvendit komunal Obiliq, Gjatë diskutimit ishin prezentë Komisioni, si dhe Pjesëmarrës,

Të pranishëm në këtë diskutim kanë qenë gjithsej 31 Pjesëmarrës,

pas marrjes së rekomandimeve nga ana e pjesëmarrësve përsëri në ora 15:00 të datë 23.04.2026 komisioni ka mbajtur takimin e fundit ku si rezultat i të gjitha takimeve kemi ardhë në përfundim që ky është ndryshimi përfundimtar i Draft Rregullores

Pas prezantimit për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 03/2024 të plotësuar dhe ndryshuar rregullorja nr. 02/2023 për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Obiliqit nuk kemi pranuar asnjë kërkesë nga qytetarët. Komente të tjera nuk kemi pranuar as në formën me shkrim.

Diskutimi publik ka përfunduar në ora 14:45.

Pjesë përbërëse e këtij raporti janë:

1. Procesverbali dhe
2. Lista e Pjesëmarrësve.

Obiliq  
23.04.2026

Komisioni:

Lulzim Mjekiqi  
Zejnullah Krasniqi  
Fazli Pervetica  
Hamit Mjeku  
Ibadete Hasani





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



**Diskutim Publik**

**“PLOTESIM- NDRYSHIM TE RREGULLORES NR 03/2024 PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E OBILIQIT”**

**PROCESVERBAL**

**Data:** 23.04.2026

**Ora e fillimit:** 13:35

Të pranishëm në këtë debat publik ishin: Lulzim Mejkiqi, Zejnullah, Fazli Përvetica dhe Hamit Mjekiqi, Drejtori i DSHPE Valon Svirca, Drejtori i DMM Rinor Kurteshi, Përfaqësues të organizatave joqeveritare, qytetarë, anëtarë të grupeve punuese për rregulloren për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

Mbledhjen e hapi kryetari i komisionit Lulzim Mjekiqi, i cili të pranishmëve iu uroi mirëseardhje dhe ia kaloi fjalën anëtarit tjetër të komisionit Fazli Përvetica.

Fazli Përvetica(Zyrtar i lartë mjedisor) para të pranishmëve prezantoi plotësim ndryshimin e rregullore nr. 03/2024 për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Obiliqit.

Fazli Përvetica; Kjo rregullore ka pasur ndryshim në disa nene, ku është bërë harmonizimi i nenit 1 (një) me Rregulloren e Nivelit Lokal për t'u qartësu mënyra e faturimit dhe e enkasimit. Te neni 6 (gjashtë) është specifikuar qartë që Komuna përcakton tarifat e operatori e bënë faturimin dhe enkasimin. Neni 8 (tetë) është paraparë që operatori ekonomik të lidhë kontratë me ekonomitë familjare, bizneset dhe institucionet tjera. Neni 9 (nëntë) qëllimi është që të ndahen ekonomitë familjare rezidente dhe jo rezidente. Jo rezidente i kemi fut diasporën sepse ata janë vetëm 1 muaj apo 2 gjatë tërë viti dhe duhet të bëjmë një kontratë të veçantë me pastrimin gjatë asaj periudhe ose me operatorin që i kryen ato shërbime duhet të kenë një kontratë dy mujore dhe të mos faturohen në kohën që nuk është rezident. Neni 10 (dhjetë) duhet ti shtohen dy paragrafë, paragrafi 1.3.1, dhe 1.3.2 me qëllim të specifikimit për institucione publike dhe OJQ-të që janë me tarifë më të ulët pra janë 9.20. Neni 14 (katërmëdhjetë) është paraparë të hyjë në fuqi kjo rregullore pas 30 (tridhjetë) ditë.

Pas prezantimit të Plotësim ndryshimin e rregullores nr. 03/2024 për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Obiliqit, Kryetari i komisionit hapi debat për komente, ide dhe propozime për të pranishmit:

- Ramadan Cunaku- A do të mund të me tregoni se a do të ketë ndryshim në çmimore dhe si e keni menduar këtë dhe çfarë përfundimi keni ardh?
- Lulzim Mjekiqi- Nuk është e përcaktuar të jetë dy muaj, pronarët duhet të lidhin kontratë me operatorin 15 euro faturë vjetore për personat që janë jo rezident, është e pandershme që ne që jetojmë këtu të paguajnë si ata që jetojnë jashtë të paguajnë faturë mujore. Nuk ka ndryshime për familjet rezidente 6.20 sic ka qenë edhe më herët.
- Ramadan Cunaku- A është paraparë në këtë rregullore për menaxhimin e mbeturinave ndarja e përshtatshme e letrës qelqit?
- Lulzim Mjekiqi: Po reduktim/ ripërdorim/riciklim në plan për menaxhimin e mbeturinave që para dy viteve ka kaluar është e paraparë 3Rjat.
- Naim Qerkezi: E çështja e kontejnerëve, a është e paraparë të blihen vet nga qytetarët?
- Lulzim Mjekiqi: Ne si komunë kemi ndarë mjete dhe kemi ofruar kontejnerë, por ende nuk kemi mundur ti futim në zbatim sistemin e 3R
- Fazli Përvetica: Në plan komunal është cekur ndarja në burim, dhe kemi me hy me një pilot projekt në një vendbanim të caktuar i dërgojmë kontejnerët dhe i shohim si funksionon dhe në bazë të mjeteve që i kemi në dispozicion dhe e përhapin në të gjithë territorin e Komunës së Obiliqit. Por me krijimin e kushteve për momentin nuk kemi kamionë për mbledhjen e mbeturinave të riciklueshme dhe nuk ka pasur mjete, por me pilot projekt për një vendbanim kemi mundësi të vazhdojmë.

Gjatë këtij debati publik nuk ka pasur ndonjë rekomandim, propozim konkret në lidhje me plotësim ndryshimin e rregullores.

Në fund të takimit, Kryetari i komisionit, z. Lulzim Mjekiqi, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre. Ai theksoi se kjo rregullore është një hap i rëndësishëm për një ambient më të pastër e cila qon edhe në një shëndet më të mirë për qytetarët e komunës tonë.

Takimi përfundoi në ora 14:45 me gjithsej 31 pjesëmarrës prej tyre gra 6, burra 25

**Procesmbajtëse:** Mimoza Hashani



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIĆ



LISTA E PJESEMARRËSVE

Debat Publik : "Draft Rregullore nr. /26 për plotësim ndryshimin e Rregullores nr.03/2024 me të cilën është plotësuar dhe ndryshuar Rregullorja nr.02/2023 për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit"

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Ora 13:30 Data: 23.04.2026

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Telefoni	E-mail	Nënshkrimi
1.	Fajmullaj Krasniqi	Obiliq	044 400 652	Zejnulla.krasniqi@ksh.gov.net	Fajmullaj
2.	Hamid Meha	Obiliq	045 770 775	hamid.meha@ksh.gov.net	Hamid Meha
3.	Mimoza Hashani	Obiliq	045 501 516	mimoza.hashani@ksh.gov.net	Mimoza Hashani
4.	Rejvan Bajrami	Penneti	044 620 377	rejanbajrami@ksh.gov.net	Rejvan Bajrami
5.	LASINOT MILICIA	HADU	045-855-548		LASINOT MILICIA
6.	MILLOT STUVCAKU	MAZGITI GRAM	045 600 256		MILLOT STUVCAKU
7.	Flabrom Mebri	Obiliq	045-706-564		Flabrom Mebri
8.	LUTKIM NUSIĆI	GRABOC	044 127 011		LUTKIM NUSIĆI
9.	VALON SUREN	MAZGITI	044-940-239		VALON SUREN
10.	NAIM QERKEZI	OBILIQ	045-163-302		NAIM QERKEZI
11.	ESAT SHALA	HADU E RE	049-336-214		ESAT SHALA
12.	Ramadhan Gumenca	Obiliq I Ri	044/642-512		Ramadhan Gumenca
13.	Bejgam Krasniqi	Obiliq	044 636 080		Bejgam Krasniqi
14.	Patriot Publica	Obiliq	049 149-523		Patriot Publica

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Telefoni	E-mail	Nënshkrimi
15.	Fehmi Gjyssev	OBILIC	045-898-418		
16.	Vlora Hulum	Obiliq	064-843-629		
17.	BEKIM KARTESHI	Kt. OBILIC	044-361-185		
18.	Besfort Kumburani	DMU-K.Obiliq	049-326-339	besfort.kumburani@ksh.gov.mk	
19.	AFRITA KRAKESKI	BACZVIC	044 624 041		
20.	FLOREN BERTANCI	OBILIC			
21.	ARISKA PERIBU	LGJESHORIP			
22.	RINOC KURTESHI	OBILIC	044 497 927		
23.	Harvan Heteu	kom Obiliq	049 20 650		
24.	LOVISA UKA	OBILIC			
25.	Visux Aliu	Obiliq			
26.	MARUJKA HALLOR	Strumore			
27.	Ganimete Vllin	Rh. Obiliq	044-402532	mayluc@ksh.gov.mk	
28.	Jasmina Rendonova	Obiliq			
29.	Indeja Hoxhi	Obiliq	045-586-081	indeja@ksh.gov.mk	
30.	Sylejman Gjoreva	Obiliq	044 292 192	sylejman.gjoreva@ksh.gov.mk	
31.	Fadi Peleviz	Obiliq	044-703-056	fadi@ksh.gov.mk	
32.					
33.					
34.					
35.					
36.					
37.					
38.					
39.					
40.					
41.					
42.					